

Përfituesit me vendime '93 e '94, në skemë 4 familje me kërkesë të veçantë

Pronat, 153 përfituesit e rinj që marrin kompensimin

Agjencia e Pronave: Ndahen 8 milionë dollarë dhe 58 ha tokë

ADA HAZIZOLLI

Pavarësisht se janë ende të panjohura argumentet që do të japë Gjykata Kushtetuese për ligjin e ri të pronave, ATP nuk është kushtëzuar, por ka vijuar normalisht procesin.

Dje është publikuar lista me përfituesit e rinj. Janë 153 familje, kryesisht me vendime të para '94, të cilët përfitojnë nga fondi i kompensimit financiar dhe fizik që agjencia disponon.

PËRFITUESIT

Pjesa më e madhe e pronarëve kanë paraqitur kërkesë për të përfituar nga skema e kompensimit financiar. Kështu, nga 153 kërkesa të miratuara, 118 janë trajtuar përmes shpërblimit në të holla, sipas formulës së përcaktuar në ligjin e ri, ku një metër katror është vlerësuar mbi bazën e zërit kadastral që prona ka pasur në kohën e konfiskimit. Vlera e kompensimit financiar që përfitojnë këto vendime është rreth 961 milionë lekë, thënë ndryshe, rreth 8 milionë dollarë. Nga ana tjetër, vetëm 38 vendime që

12

MILIONE dollarë është fondi i ndarë deri më tani nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave bazuar në skemën e re, ku një metër katror tokë llogaritet me çmimet që janë sot në treg, ndërsa zëri kadastral është ai i origjinës

datojnë në periudhën 1993 dhe 1994 kanë përfituar nga fondi fizik që agjencia ka në posedim. Por në radhët e përfituesve ka edhe nga ata me vendime të pas '94, por që kanë aplikuar përmes kërkesave të veçanta. Gjithsej janë 4 familje, të cilat kanë preferuar të marrin një pjesë të vlerës së kompensimit dhe të heqin dorë nga pjesa e mbetur. Sikundër edhe pritej, një pjesë e konsiderueshme e

PRONARËT E PENALIZUAR NGA SKEMA E RE

Skema e re e kompensimit të pronave e ka dhënë impaktin e parë penalizues ndaj pronarëve që u është kthyer një pjesë e pronës së konfiskuar nga regjimi komunist. Janë 4 familje, të cilat janë konsideruar të kompensuar dhe u është hequr e drejta e përfitimit financiar apo fizik për pronën e mbetur. "Janë 4 aplikime, vendimet e të cilave nuk përfitojnë kompensim fizik nga fondi i tokës në dispozicion të ATP-së, për shkak se vlerësimi financiar i sipërfaqeve të përfituara nga ligji 7501, datë 19.07.1991, 'Për tokën', rezultoi më i madh në krahasim me vlerësimin financiar të vendimit për kompensim të subjekteve përfituese", thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave.

FONDI

Publikimi i kësaj liste të radhës e çon në 12.5 milionë dollarë fondin e ndarë nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave brenda këtij viti. Rreth 4.5 milionë dollarë u përdoren për kompensimin e 34 familjeve rreth dy muaj më parë. Sa i takon tokës bujqësore, nga fondi 23 mijë ha që ka ATP, janë ndarë deri më tani 58.5 ha. "Me kuadrin e vjetër ligjor nuk është bërë kurrë më parë kompensim fizik nga fondi i tokës, ndërsa me kuadrin e ri ligjor, ATP ka shpërndarë një fond toke prej 58,5 ha, duke konfirmuar



Vendimet para 1994, procesi i aplikimeve i hapur

Pas vlerësimit ekonomik për vendimet e dhëna në periudhën 1993 dhe 1994, Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka hapur procesin e aplikimit. Përgjatë këtyre muajve, numri i aplikimeve të depozituara ka qenë i ulët. Nga rreth 3750 familje përfituese, vetëm rreth 300 kanë dorëzuar kërkesë. "Njoftojmë se të gjitha subjektet, të cilat kanë aplikuar apo do të aplikojnë për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të vlerësuarra financiarisht, do të trajtohen me kompensim vetëm pasi të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ i kërkesës dhe gjithë dokumentacioni të depozituar nga ana e tyre. Sfarojmë se procesi i aplikimit dhe ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të vlerësuarra financiarisht për vitet 1993 dhe 1994 është një proces i vazhdueshëm dhe i hapur për të gjitha subjektet", thuhet në njoftimin e ATP-së, ku theksohet po ashtu se pronarët do të kenë mundësi të kompensohen vetëm pasi të jetë verifikuar i gjithë dokumentacioni i depozituar prej tyre.

eficiencën e zbatimit të ligjit të ri për realizimin e procedurave të kompensimit fizik. Ndërsa fondi financiar i shpërndarë vetëm gjatë 3 muajve me kuadrin e ri ligjor është 1 522 149 306 lekë, krahasuar me fondin financiar të shpërndarë në total për 9 proceset e mëparshme gjatë viteve 2005-2014 për kompensimin e pronës sipas kuadrin të vjetër

ligjor, rezultoi të jetë pak më tepër se 1/3-a e këtij fondi, gjë që konfirmon përsëri eficiencën e zbatimit të ligjit të ri për realizimin e procedurave të kompensimit financiar", bëhet me dije nga drejtoresha Sonila Qato. Nga fondi vjetor kanë mbetur edhe rreth 12 milionë dollarë që nëse nuk do të ndahen brenda këtij viti, do të mbarten për t'u ndarë vitin e ardhshëm.

LISTA E PRONARËVE QË KOMPENSOHEN NE TE GJITHE VENDIN

LISTA E PRONARËVE QË PËRFITOJNË NJË PJESË TË KOMPENSIMIT DHE HEQIN DORË VULLNETARISHT NGA PJESA E MBETUR (KËRKESAT E VEÇANTA)

BESIM ZELIJA
LLESH ARAPI
ISMAIL GASHI
ALI AZEMI

PRONARËT QË PËRFITOJNË NGA KOMPENSIMI FIZIK

DHIMITËR DIAMANTI
IBRAHIM HOSTOPALLI
HYSEN SARAÇI
ANÇE BUSHI
RAMIZ PIRANEJ
YSNI XHELO
KAMBE HARJA
RRAPO DEMO
GJYKË HOXHAJ
JORGJI ZAHARIA
SULEJMAN KARRIQI
QAZIM ALIA
MUSTAFA MËRKURI
XHEMAL BALLIU
LLAMBRO MBYETI

LISTA E PRONARËVE QË JANË KONSIDERUAR TË KOMPENSUAR DHE NUK PËRFITOJNË MË ME SKEMËN E RE

IZET BOÇI
TEKI HOXHALLARI
IRFAN EMIN
QAZIM PIRRA

LISTA E PRONARËVE QË PËRFITOJNË KOMPENSIM FINANCIAR

ALI ARBANA
EMINE BALLA
BESNIK KARAKAÇI
GJYLJE BUSHATI
TODI XEGA
HYSEN DIBRA
HAMDI SELIMI
SHABAN BUSHATI
KOLI GJETHI
MEHMET LLOSHI
DHIMITËR DIAMANTE
SHEFQET ZQJANI
SELMAN QUKU
SAMI MANÇAKU
RASIM HEBOVJIA
NAUN SIMAKU
ANDON RRUSHI
FIQIRIJE ALIÇKOLLI
AGIM KASTRATI
MIHAL KORETA
PREKOP PJESHKAZINI
REFAT SKËRA
MILTO HIDO
NASI XHOXHI
HYSEN BAGOI
LIRI KAPLLANI
ADLI HATIBI
VLADIMIR GJIKI
IBRAHIM QINAMI
DODONA KARAJFILI
ARIF HYSKJA
STAVRO STAVRI
AGIA STEVENS
ALI KAMATA
LUIGJ BUSHATI
URANI LEKA
SOTIR POPA
ABDYLL DRAGUSHA

MEHMET BERBALLA
PETRIT GERBI
MYZAFER MANCE
IBRAHIM HISTOPALLI
MITRO VASI
ABDYLL ABDIHOXHA
JAHO DAMNORI
KSENOFON EKONOMI
MURAT HYSENAJ
VIKTOR LLUPA
HYSEN SARAÇI
RIZA HOXHA
SOTIR MBROJA
SALJAN MUÇO
RIFAT MANI
SELEJMAN PECENI
SAMI KARKINI
FILLIP GUGUSHI
FITNETI XHAKUPI
BAHRI ALIDINAJ
JANI CUPATA
BELKIZE ZENELI
FATMIR DALIPI
KARAMAN PAFTALI
ANÇE BUSHI
IBRAHIM NEZIRI
SHEFQET METANI
LUIZA PAPAJANI
FEMI SINOIMERI
OSMAN BAHUSHI
SELVI ZEQAJ
SHABAN QUKA
RAMAZAN BEGA
RESHIT LLESHI
HYSEN GUZA
DEMIR DEMIRI
THANAS SHENKO
RAMIZ PIRANAJ
HAZBI LAÇI
EQREM HAMOLLI
SADI PASHOLLARI

MUNTAZ KOKOLARI
LON GJINI
HAXHI VELIU
MYSLIM KARAPICI
QAMILE SALIU
NESHAT BITURKU
HYSEN SENKAJ
MUHARREM SAUKU
MUHARREM KUQI
FADIL JANINA
SHEFIKAT VYSHKA
HAXHI VELIU
MIKEL KARROCA
IBRAHIM SKUQI
MYRTEZA KADIU
APOSTOLL PROKO
MERSIN ZERE
AGIM DERVISHI
KAMBER HARJA
SHYQËRI MISIRI
RUSTEM SPAHIU
VASIL MECI
MALIQ HOTI
HAMIT HOXHOLLI
NURI QANI
VLASH RESELI
ARIF DINO
MIKAIL JANÇE
SHEFQET NDROQI
LUMNIJE GJYLI
TOIL PUKA
FEJZO DINO
CELIK BERBERI
MARIJE DEMIRI
KEL DRAGUSHA
RRAPO DEMO
DEMIR KOSTURI
SAHLI LAMI
HYSEN QERIM